

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE GJIROKASTËR

Nr. 605 Rep.

Nr. 284 Kol.



KONTRATË SHITJE AKSIONESH

Sot më datë 08.03.2019 , përpara meje Vangjeli S. Marko, Noterë në Bashkinë Gjirokastrë, regjistruar në Dhomën e Noterëve Gjirokastrë, u paraqitën palët e mëposhtme:

Pala shitese: Z. Piro Karanxha, i biri i Ilia, lindur ne Gjirokastrë me date 18.11.1972 dhe banues ne Dervician Gjirokastrë, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, identifikuar përmes letërnjoftimit me numer personal identiteti H21118022T.

dhe Antonios Ouzas , me shtetësi greke, i biri i Vasileios, lindur ne Selanik GRC dhe banues në Janinë, më 07.07.1970, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës I Letërnjoftimit grek nr. AB807777.

Pala Blerese Z. Nikolla Gjoni, atësia Viktor, i datëlindjes 13.10.1962, lindur dhe banues në Gjirokastrë, mbajtës i kartës së identitetit nr. ID personal G21013030E, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar

PREMISE KONTRATE

Referuar Ekstraktit të Q.K.B për subjektin “Gjirofarma” sha, me NIPT K43522610E, rezulton se ai është një subjekt tregtar i së drejtës shqiptare. Selia e kësaj shoqërie është e përcaktuar në Gjirokastrë DROPULL I SIPERM BODRISHTË Bodrishtë, kodi postar 6006, rruga nacionale Gjirokastrë-Kakavije, km 25, zona kadastrale 1234, nr. pasurie 72/30. Vlera totale e kapitalit themeltar të shoqërisë është 178.000.000 leke, Vlera e kapitalit të shlyer: 178.000.000 leke Numri i aksioneve: 89.000, Vlera nominale: 2.000

Objekti veprimtarisë së shoqërisë është Mbledhja e perpunimi i qumështit, tregtimi i tij dhe nënprodukteve, import eksport tregti mallra të ndryshëm. Prodhimin dhe tregtimin e lengjeve dhe të frutave. Import , perpunim dhe tregtim I mishit.

Pala shitese aksionari **Piro Karanxha** zoteron aksione me të drejtë vote : 44.500, me Përqindja e pjesëmarrjes 50,00 , duke i dhënë të drejtën e pjesëmarrjes në shoqëri me 50% të kapitalit themeltar të saj.

Pala shitese aksionari **Antonios Ouzas** zoteron aksione me te drejte vote : 44.500, me Përqindja e pjesëmarrjes 50,00 , duke i dhene te drejten e pjesemarrjes ne shoqeri me 50% te kapitalit themeltar te saj.

Ne palet e mesiperme, pas negociatave te realizuara gojarisht, ne baze te nenit 79, 80, 659, 660, 690, 705 e vijues te Kodit Civil, si dhe ne nenin 73/b te ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" me vullnet te lire, te plote dhe te pavesuar, disponojne si me poshte vijon:

NENI 1

OBJEKTI

Objekti i kesaj kontrate eshte shitja e 2.5% te aksioneve te secilit aksioner te shoqerise "Gjirofarma" sh.a, ne total 5% te perqindjes se pjesemarrjes pjese te kapitalit themeltar te shoqerise "Gjirofarma" sh.a me NIPT K43522610E nga shitesit Piro Karanxha e Antonios Ouzas tek bleresi Nikolla GJONI kundrej pagimit te cmimit kontraktor ne vleren totale prej 75.000 (shtatedhjete e pesemije) euro, secili shites 37 500 (tridhjete e shtate mije e peseqind) euro .

NENI 2

PAGIMI I CMIMIT

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, pala blerese paguan cmimin kontraktor sipas nenit 1 te kesaj kontrate permes sistemit bankar, ne llogarine bankare te seciles pale shitese me vete.

Pagimi do te behet i plote me nje kest te vetem, brenda dates se kontrates, duke i dhene fuqi asaj per efekt te regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI 3

TRASFERIMI AKSIONEVE DHE RREGJISTRIMI I KONTRATES NE QKB

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, pala shitese Piro Karanxha dhe Antonios Ouzas humbet cdo te drejte pronesie dhe zoterimi, secili aksionar ne masen 2.5%, mbi aksionet e kapitalit themeltar te shoqerise "Gjirofarma" sha dhe pala blerese Nikolla Gjoni behet pronare dhe zoteruese e 5% te aksioneve te kapitalit themeltar te shoqerise "Gjirofarma" sha.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate, bleresi Nikolla Gjoni behet aksionar i trete i "Gjirofarma Sh.a, me 4.450 aksione ne vlere nominale 8.900.000 leke, me perqindje pjesemarrje 5%,

Aksionari Piro Karanxha ngelet me 47.5% te perqindjes se pjesemarrjes me 42.275 aksione me te drejte vote me vlere nominale 84.550.000 leke



The bottom of the document features several handwritten signatures and a circular stamp. From left to right, there are three distinct signatures. The fourth element is a circular stamp with text around the perimeter, including 'E SHQIPERISE' at the top and 'QENDRE KOMBETARE E BIZNESIT' at the bottom. To the right of the stamp is a fourth signature.

dhe Antonios Ouzas ngelet me 47.5 % te perqindjes se pjesemarrjes me 42.275 aksione me te drejte vote me vlere nominale 84.550.000 leke

Palet bien dakord qe kjo kontrate te rregjistrohet ne QKB dhe veprimet administrative per rregjistrimin e saj te kryhen nga administratori i shoqerise, ose nje person i autorizuar prej tij me shkrim.

NENI 4

DISPOZITA FUNDORE

Kjo kontrate redaktohet ne 3 (tre) ekzemplare autentik, ne gjuhen shqipe. Secila pale kontraktore mban nga nje ekzemplare, nje prej tyre depozitohet nga bleresi ose personi i autorizuar nga administratori aktual ne QKB;

Persa nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kontrate do te zbatohen dispozitat e kodit civil ku trajtohet kontrata e shitblerjes si dhe legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Cdo mosmarreveshje qe mund te lind midis paleve, do te zgjidhet me marreveshje, ndryshe kompetente per shqyrtimin e mosmarreveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Gjirokaster;

Kesaj kontrate i bashkangjiten 1- Ekstrakt QKB; dhe 2- Leternjofimet e paleve kontraktore;, RBS .

Kjo kontrate, pasi u redaktua nga palet, u kuptua permbajtja e saj dhe u gjet ne perputhje me vullnetin e lire, te plote dhe te pavesaur te seciles pale, nenshkrhet personalisht nga palet duke e bere ate te detyrueshme sipas nenit 659, 660 dhe 690 te Kodit Civil.

Shtetasit grek, shitesit Antonios Ouzas, kjo kontrate iu perkthye dhe iu shpjegua nga une noterja ne gjuhen greke.

Secila pale shprehet se eshte e ndergjegjshme dhe e pergjegjshme per pasojat juridike te kesaj kontrate dhe zotohen qe do te permbushin me korektesi maksimale detyrimet qe burojne prej saj.

PALET

SHITESIT

BLERESI

NOTERE

VANGJELI S. MARKO

Antonios Ouzas
Ando Ouzas
Ando Ouzas

Vangjeli S. Marko

Nikolla Gjoni
Nikolla Gjoni

